



GRATË DHE TË DREJTAT E TRASHËGIMISË NË PRONËN E PALUAJTSHME NË KOSOVË

Data e dorëzimit: Tremujori i I-rë 2016

Emri: Monitorët Mobil (Gjyqësori)

Departamenti/Zyra/Njësi/: Njësia Këshilluese për
Çështje të Drejtësisë – Ekipi Mobil/ Departamenti
i Fuqizimit

Përmbajtja

Shkurtesa	2
Përmbledhje ekzekutive	2
1) Hyrje	3
2) Historiku	7
3) Metodologjia: mbledhja e të dhënave	8
4) Korniza ligjore: pengesat për të drejtat formale	11
A) Legjislacioni për trashëgiminë	11
B) Regjistrimi i transaksioneve të pronave të paluajtshme	17
5)	
Mungesa e mbrojtjes të grave për të drejtën trashëgimore për pronën e paluajtshme nga i	
nstitucionet noteriale të Kosovës	20
6) Përfundime	22
Rekomandime:	24
SHTOJCA.....	0

Shkurtesa

AIFCSCO	Udhëzimi Administrativ për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale
UAZLK	Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Ligjit për Kadastër
UATN	Udhëzimi Administrativ për Tarifat Noteriale
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
LF	Ligji për Familjen
LT	Ligji për Trashëgiminë
LPJ	Ligji për Procedurën Jokontestimore
LN	Ligji për Noterinë
LPDTS	Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale
ZKGJC	Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij raporti është që të hetojë qasjen e grave në trashëgiminë e pronës të

paluajtshme në Kosovë. Neni 7 i Kushtetutës së Kosovës dhe korniza e mëvonshme ligjore¹, njeh barazinë e grave dhe ndarjen e barabartë të pasurisë në mes të trashëgimtarëve. Megjithatë, ekzistojnë ende zakone tradicionale që tentojnë t'i japin përparësi qasjes së pasardhësit mashkull në raport me femrën në pronën e paluajtshme. Aktualisht, nuk ka rregulla të qarta procedurale ligjore për mbrojtjen kundër dhënies së përparësisë së pasardhësve meshkuj. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të mbivendosjes së juridiksionit në mes të noterive dhe gjykatave dhe mungesës të mbrojtjes ligjore për të siguruar ndarjen e barabartë të pronës së paluajtshme në mes të trashëgimtarëve. Këto probleme vihen re më tepër në nivel administrativ: komunave u mungon ekspertiza profesionale dhe teknike; konkretisht, atyre u mungon Regjistri Qendror i përditësuar i Gjendjes Civile për të identifikuar si duhet trashëgimtarët. Për më tepër, gratë shpesh dekurajohen për të pohuar apo kërkuar të drejtat e tyre trashëgimore dhe shumica prej tyre mund të jenë të painformuara në lidhje me të drejtat ligjore. Për shkak të disa mangësive ligjore në shumë nivele dhe në atë ndërinstitucional, ky raport tregon se sistemi aktual ligjor lidhur me qasjen e grave në trashëgiminë e pronës të paluajtshme është problematik. Raporti identifikon çështje të caktuara legjislative dhe ofron rekomandime për institucionet përkatëse. Këto rekomandime mund të ndihmojnë noteritë, gjykatat, zyrat komunale të regjistrimit civil dhe autoritete të tjera që të sqarojnë më mirë mangësitë ligjore që cenojnë gratë dhe si rezultat mund të forcojnë rolin e tyre si garanci për barazi gjinore.

1) Hyrje

¹ Ligji për trashëgiminë, nën titullin “Barazia në trashëgimi”, përcakton në nenin 3.1 se: “Të gjithë personat fizik në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”.

Qëllimi i këtij raporti është të adresojë çështjet e ndërlidhura me të drejtat trashëgimore të grave për pronën e paluajtshme në Kosovë. Në pranverë të vitit 2015, Ekipi Monitorues Mobil i EULEX-it (EMM), në kuadër të Njesisë Këshilluese për Çështjet e Drejtësisë (NJKÇD), ka kryer një hulumtim i cili u përqendrua në punën e këtyre institucioneve gjyqësore: gjykatat e Kosovës, zyrat e noterëve në Kosovë dhe zyrat komunale të gjendjes civile (ZKGJC). EULEX-i po ashtu ka shqyrtuar ligjet dhe zakonet ekzistuese për të vlerësuar ndikimin e tyre në të drejtat trashëgimore. Të drejtat trashëgimore të grave në Kosovë, në veçanti mospërputhja mes kornizës ekzistuese ligjore dhe praktikës, është një çështje e njohur mirë, të cilën shumë organizata e kanë adresuar në raporte dhe iniciativa të ndryshme me fokus më të madh në perceptimet kulturore të shoqërisë për këtë çështje.² Edhe pse disa nga këto raporte kanë vënë në dukje kufizimet e caktuara ligjore, EMM-ja ka identifikuar mungesën e raportimit për efikasitetin e institucioneve gjyqësore dhe shërbimeve të tjera në këtë drejtim. Kështu, duke u bazuar në hulumtimet e mëparshme, EMM-ja ka për qëllim të konstatojë se ende ekzistojnë problemet, pavarësisht ligjeve që sigurojnë barazinë e grave në çështjet e trashëgimisë.


Për ta hetuar këtë, EMM-ja ka kryer analiza të rasteve studimore në gjykatat e Kosovës dhe nga informacionet e siguruar nga zyrat e noterëve në Kosovë dhe zyrat komunale të gjendjes civile. Duke shfrytëzuar këto të dhëna, raporti përshkruan pengesat për të drejtat formale në kuadrin ligjor me synim në legjislacionin e trashëgimisë, si dhe regjistrimin e transaksioneve të pronave të paluajtshme. Në veçanti, ai ve në dukje dispozitat e paqarta, së bashku me mangësitë ligjore, të cilat lejojnë vazhdimin e praktikave diskriminuese kundër grave që kërkojnë të trashëgojnë pronën e paluajtshme. Për më tepër, noteritë në Kosovë nuk kanë qenë në gjendje të mbrojnë të drejtat e trashëgimtareve gra. Brenda sistemit noterial, shumë gra heqin dorë nga e drejta e tyre trashëgimore duke i bërë edhe më të rëndësishme masat mbrojtëse për trashëgimtarët gra në këtë institucion jetësor. Në këtë raport, EMM-ja jep rekomandime për përmirësimin e institucioneve të Kosovës për ta adresuar këtë çështje në mënyrën e duhur.

Ashtu si paraqet në figurën 1 më poshtë, Kosova ka përqindjen më të ultë të pronave të paluajtshme të regjistruara në emër të grave në rajonin e Ballkanit.³

Figura 1: Pronat e paluajtshme të regjistruara në emër të grave (përfshirë pronën e përbashkët)

² Shih: “Të drejtat e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë”. (mars 2011) Qendra Kosovare për Studime Gjinore.

³ TKN në mbështetje të bërjes së Politikave të Bazuara në Prova: Toka dhe Gjinia në Ballkanin Perëndimor, dokumenti i përgatitur për prezantim në “Konferencën e Bankës Botërore për Tokën dhe Varfërinë 2014”, Banka Botërore – Washington DC, mars 24-27, 2014, f. 23. “Projekti për Pronën e Paluajtshme dhe Kadastër – RECAP, Anketa vjetore e përmbytjes së shërbimeve ndaj konsumatorëve – Faza e Dytë” (prill 2014) i publikuar nga Kompania EA Consulting; Dokumenti tregon pjesëmarrje pak më të madhe të pronareve femra: 16%.



Zakonet e trashëgimisë në Kosovë, ende favorizojnë në masë të madhe mashkullin në raport me pasardhëset femra. Pas vdekjes së babait apo bashkëshortit, vajza/gruaja është shpesh në rrezik për mos marrjen e pjesës së saj të ligjshme të pasurisë, përfshirë pasurinë e paluajtshme. Gratë që varen nga të afërmit e tyre meshkuj për sigurinë ekonomike janë veçanërisht të cenueshme dhe janë në rrezik të lartë të vihen para presionit familjar që të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore dhe të lejojnë vijën mashkullore të trashëgimisë të pronave të familjare.

Ky problem është spikatur nga çështjet institucionale dhe administrative. Për shembull, gjykatat dhe noteritë, të dyja kanë mandat ligjor që të merrem me rastet e trashëgimisë, gjë që krijon konfuzion. Përveç kësaj, për shkak të mungesës së të regjistrit të besueshëm qendror të gjendjes civile në mbarë vendin, zyrat komunale të gjendjes civile jo gjithmonë e dinë se sa anëtare ka familja në një situatë të caktuar trashëgimie.

Nga ana ligjore, neni 7.2 i Kushtetutës së Kosovës ndalon në mënyrë të qartë diskriminimin e grave. Për më tepër, neni 22 përcakton se Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEFDG) është përfshirë shprehimisht në ligjet e Kosovës. Megjithatë, pavarësisht nga masat mbrojtëse legislative për gratë, ende vazhdon tradita kulturore e dhënies së përparësisë ndaj trashëgimtarëve meshkuj.

Neni 7.2 Kushtetuta e Kosovës

‘Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje si të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.’

Neni 22 Kushtetuta e Kosovës

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(...)

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(...)

2) Historiku

Shumë nga ligjet që kanë të bëjnë me të drejtën pronësore të grave në Kosovë janë relativisht të rinj, më i hershmi daton në vitin 2003.⁴ Në kuadër të zakoneve të Kosovës, të përcaktuara me rregullat tradicionale si Kanuni i Lekë Dukagjinit, gratë janë përjashtuar nga trashëgimia familjare pasi prona ka ndjekur vijën mashkullore. Pra, bartja e pronës tek gratë ka nënkuptuar bartjen jashtë vijës trashëgimore. Për më tepër, kuptimi tradicional për gratë të pranojnë trashëgiminë e tyre shpesh shihet si turpërim për burrat apo si paraqitje e turpshme në publik, si mungesë e mbështetjes të të afërmeve meshkuj⁵. Në këtë kontekst, avancimi i barazisë gjinore ka ndodhur pasi grave u është dhënë mbrojtje e caktuar ligjore dhe organizatat që kanë punuar në projekte janë përqendruar në ndryshimin e qëndrimeve⁶. Përkundër këtyre përmirësimeve, ende zotërojnë perceptimet tradicionale. Me mangësitë ligjore dhe dispozitat e paqarta, këto qëndrime pasqyrohen në procedurat de facto të trashëgimisë.

Një tjetër kuptim i rëndësishëm në këtë kontekst është pavarësia e ulët ekonomike e grave në Kosovë. Numri i grave që punojnë në Kosovë është ndër më të ulët në tërë Evropën⁷, duke i bërë këto gra të varura nga familja për mirëqenien e tyre. Kjo varësi e shoqëruar me traditat kulturore mund të jetë e dëmshme për gratë që përballen me presion në familje për të hequr dorë nga trashëgimia. Të kuptuarit e këtyre faktorëve kulturorë dhe ekonomikë ndihmojnë për të shpjeguar nivelin e lartë të heqjes dorë nga gratë të dhëna me hollësi në këtë raport.

⁴ “Programi i të Drejtave Pronësore (PDP) Çështjet Gjinore, Pronësore dhe Mundësitë Ekonomike në Kosovë”. (janar 2015) USAID. f 7.

⁵ “Heqja dorë nga të drejtat e tyre? Pengesat e Grave në të Drejtën Pronësore në Kosovë”. (2015) Joireman, Sandra. f 11.

⁶ Shih: “Të Drejtat Pronësore të Grave në Kosovë: “Mos hesht””. (January 2014). UNMIK. “Heqja dorë nga të drejtat e tyre? Pengesat e Grave në të Drejtën Pronësore në Kosovë”. (2015) Joireman, Sandra. “Të Drejtat e Grave në Trashëgiminë e Pronës në Kosovë”. (mars 2011) Qendra Kosovare për Studime Gjinore.,

⁷ “Të Drejtat e Grave në Trashëgiminë e Pronës në Kosovë”. (mars 2011) Qendra Kosovare për Studime Gjinore. f 17.

3) Metodologjia: mbledhja e të dhënave

Ekipi i EMM-së ka mbledhur të dhëna nga dosjet e lëndëve në Gjykatën e Apelit si dhe nga informacionet e mbajtura nga noteritë.

Gjykata e Apelit:

Në pranverë të vitit 2015, EMM-ja kreu hulumtim në terren duke mbledhur lista dhe detaje nga dosjet e lëndëve të Gjykatës së Apelit për raste⁸ të ndërlydhura me të drejtat trashëgimore, në cilat gratë kanë qenë palë në to për vitin 2013 dhe 2014. Gjykatat e shkallës së parë nuk ishin në gjendje të siguronin të dhënat përkatëse pasi kjo do të kërkonte kërkimin manual më të gjerë të regjistrave që gjë nuk u bë e mundur për këtë raport. Prandaj, analiza e EMM-së është përqendruar në 29 raste të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL)⁹ në Gjykatën e Apelit (GJA).

Sipas informacionit të pranuar nga Gjykata e Apelit, vetëm 6.8% e **të gjitha ankesave civile** (290 nga 4,265) janë iniciuar nga gratë si palë ankuese. Shumica e këtyre padive (88% nga 290) përfshijnë bashkë paditësit dhe bashkë të paditurit meshkuj. **Vetëm 12% (35 raste) kishin si paditëse “vetëm gra”.**

Noteritë:

Në maj 2012, hyri në fuqi Ligji për Noterinë, për transferimin e regjistrimit dhe verifikimit të kontratave të pronës si dhe procedurave të trashëgimisë tek noterët. Ky zhvillim ofroi një mundësi më të mirë për të siguruar të dhëna më të sakta, pasi regjistrat e noterisë janë në përgjithësi më të saktë dhe më të detajuar se regjistrat e gjykatës, në veçanti pasi disa nga noterët mbajnë bazë elektronike të të dhënave¹⁰, në të cilat EMM-ja kishte mundësi të qasej.

Pas kërkesës për informacion të përgatitur nga Oda e Noterëve të Kosovës (ONK), u shpërnda një pyetësor tek të gjithë 74 noteritë e Kosovës në fillim të marsit 2015. Më 21 prill 2015, ONK-ja paraqiti raportin (shtojca I) tek EMM-ja të bazuar në përgjigjet e 19 noterive (25% të numrit të përgjithshëm të noterive) nga pjesë të ndryshme të Kosovës. Ky përqendrohet në **pjesëmarrjen e**

⁸ Për nevojën e kufizimit të kritereve të kërimit në bazën e të dhënave, studimi u përqendrua kryesisht në “Pengimin e posedimit” dhe “Verifikimin e pronësisë” ankesa civile të paraqitura nga gratë për të mbrojtur të drejtat e tyre pronësore. Lëndët e tjera civile dhe penale në lidhje me pronat e paluajtshme janë shpërfillur, duke pasur parasysh numrin e ultë.

⁹ [Baza e të dhënave SIML](#) nuk pasqyron secilën lëndë të regjistruar dhe fazat e saj procedurale, sepse është ende në zhvillim e sipër. 142 lëndë ishin për verifikimin e pronësisë dhe 148 për çështje të pengimit në posedim.

¹⁰ Bazë e përgjithshme elektronike e të dhënave për të gjithë sistemin noterial të Kosovës ishte ende në zbatim në shkurt 2016.

grave në katër akte kryesore ligjore dhe akte të cilat janë të autorizuar t'i vërtetojnë noteritë, përkatësisht:

- a) Kontratat e shitjes me përfitues gratë.
- b) Vendimet e trashëgimisë me përfitues gratë
- c) Heqja dorë e grave nga të drejtat trashëgimore.
- d) Kontratat e dhurimit nga gratë.

Të dhënat e mbledhura theksojnë pjesëmarrjen e grave në transaksione noteriale në lidhje me trashëgiminë. Edhe pse këto të dhëna përmbajnë informacione nga noteritë në tërë Kosovën, është ende e rëndësishme të theksohet se jo çdo gjykatë apo noteri ka vepruar në pajtim me kërkesën e EMM-së dhe për këtë arsye hulumtimi ka kufizime. Megjithatë, përkundër kësaj, të dhënat e mbledhura theksojnë të njëjtat çështje legislative dhe në këtë mënyrë ofrojnë një pasqyrë të fushave të problemit.

Informacioni i mbledhur përfshin periudhën pothuaj trevjeçare (maj 2012 deri në mars 2015), dhe gjetjet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

NOTERITË ¹¹	Kontrata e shitjes me përfitues femra	Vendime të trashëgimisë me përfitues femra	Heqja dorë nga e drejta për trashëgimi nga gratë	Kontrata dhurimi nga gratë
Zyra e Noterit A, Istog	30	45	102	
Zyra e Noterit B, Shitë	55	27	111	18
Zyra e Noterit C, Gji	11 nga 163	10 nga 30	20 nga 30	52 (1 përfituese femër)
Zyra e Noterit D, Mitrovicë	7	5	37	
Zyra e Noterit E, Prishtinë	203	13	27	
Zyra e Noterit F, Pri	29	15 (19 gra në total)	45 (97 gra në total)	
Zyra e Noterit G, Kli	12	8	19 (3 femra të favorizuara)	
Zyra e Noterit H, Vit	9	4	21	2
Zyra e Noterit I, Su	16	25 (gra)	238	
Zyra e Noterit J, Pri	75 (49 shitës 26 blerës)	52 (gra)	80 (gra)	1
Zyra e Noterit K, Kaçanik	12	4	asnjë	
Zyra e Noterit L, Pri	16	16	71	6
Zyra e Noterit M, Prishtinë	60		18	4
Zyra e Noterit N, Fe	13 nga 202	21 nga 48	27 nga 48	
Zyra e Noterit O, Kamenica	57 (35 shitës 22 blerës)	18	44	
Zyra e Noterit P, Pri	12 (8 shitës 4 blerës)	36	67	15
Zyra e Noterit Q, Su		5 nga 37		
Zyra e Noterit R, Vit	18 nga 154	17 nga 77	60 nga 77	15

¹¹ Noteritë udhëzohen ashtu si parashihet nga Oda e Noterëve. Komunikimi i plotë është në shtojcën I.

i				
Zyra e Noterit S, Pri zren	42	33	24	

4) Korniza ligjore: pengesat për të drejtat formale

EMM-ja vëren se disa nga dispozitat në kornizën ligjore të Kosovës të përmendura më poshtë, të cilat janë të lidhura me trashëgiminë dhe regjistrimin e transaksioneve të pronave të paluajtshme, paraqesin mangësi në legjislacionin gjë që bën të mundur vazhdimin e praktikave diskriminuese kundër grave të cilat kërkojnë të drejtat e tyre për pronë të paluajtshme. Në veçanti, janë vërejtur pjesët e mëposhtme të legjislacionit problematik:

A) Legjislacioni për trashëgiminë

Marrëveshjet për ndarjen e pronës:

Neni 172 i LPJ-së lejon që trashëgimtarët të vendosin lirisht se si të ndajnë pasurinë në mes tyre. Në kontekstin e traditës në Kosovë, kjo mund të bëjë lehtësisht të mundur ndarjen e pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët gra.

Heqja dorë:

Një sërë raportesh¹² dhe organizatash kanë vërejtur se familjet mund t'i vënë gratë para një presioni kur është fjala për qasjen në pronën e paluajtshme. Në veçanti, ka ankesa se gratë detyrohen të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore në favor të meshkujve ashtu siç dikton tradita. Kjo konfirmohet nga të dhënat e mbledhura nga EMM-ja pasi heqjet dorë e grave nga trashëgimia janë ndër aktet/shkresat më të zakonshme të certifikuara noteriale (Shtojca I). Komplikimet që përfshihen në kërkesat ligjore për heqje dorë janë evidentuar më poshtë.

Neni 130 i LT-së lejon trashëgimtarin të heqë dorë nga trashëgimia. Si masë mbrojtëse heqja dorë nuk mund të bëhet para çastit të vdekjes kur fillon procedura e trashëgimisë. Për më tepër, ai duhet të nënshkruhet dhe ky nënshkrim duhet të vërtetohet nga “organi kompetent”, i cili nuk është i emëruar qartë dhe as i përcaktuar.

Fatkeqësisht Ligjit të ri për Barazinë Gjinore të vitit 2005, i cili ka zëvendësuar Ligjin për Barazinë Gjinore të vitit 2004, edhe më tej i mungon mbrojtja ndaj grave. Ligji për Barazinë Gjinore në nenin 16, paragrafi 13 duket se paraqet një kërkesë tjetër për heqjen dorë: trashëgimtarët mund të heqin dorë nga pjesa e tyre pas “regjistrimit” të pronës së paluajtshme të trashëguar. Edhe pse kjo dispozitë mund të sigurojë dokumentacionin zyrtar që tregon se çfarë kanë

¹² Shih: “Programi i të Drejtave Pronësore (PDP) Çështjet Gjinore, Pronësore dhe Mundësitë Ekonomike në Kosovë”. (janar 2015) USAID. Dhe “Të Drejtat e Grave në Trashëgiminë e Pronës në Kosovë”. (mars 2011) Qendra Kosovare për Studime Gjinore.

të drejtë të trashëgojnë ligjërisht gratë, kuptimi i “regjistrimit” është i paqartë dhe nuk është i përcaktuar shprehimisht në LPJ. Megjithatë, Ligji i ri për Barazinë Gjinore nuk e ofron as këtë mbrojtje të dobët dhe në vend të kësaj ka krijuar vetëm mekanizmat mbrojtës në marrëdhëniet e punës dhe arsimimit. Pra, mbrojtja e mëparshme ka humbur ashtu si ka humbur edhe mundësia për të shtuar më tej mbrojtjen për barazinë gjinore.

Neni 164, paragrafi 5 dhe neni 165 i LPJ-së lejon një deklaratë verbale para një personi të autorizuar kur trashëgimtari është i paaftë për të nënshkruar deklaratën e heqjes dorë. Megjithatë, nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet me “paaftësi” në këtë dispozitë dhe në cilat raste nuk është i nevojshëm nënshkrimi. Kjo pasiguri mund të çojë në keqpërdorim të dispozitës në rastet të cilat nuk kualifikohen për deklarata verbale. Si rrjedhojë, janë të nevojshme masa mbrojtëse të mëtejshme.

Neni 22, paragrafi 7 i Udhëzimit Administrativ për Tarifat Noteriale (UATN) rregullon tarifën noteriale për heqjen dorë ndaras nga procedura trashëgimore. Formulimi i kësaj dispozite mund të interpretohet si lejim i trashëgimtarëve që të heqin dorë para çastit të vdekjes dhe kështu mund të ketë nevojë të harmonizohet me nenin 13 të LPJ-së. Hulumtimi i EMM-së nuk gjeti asnjë heqje dorë para vdekjes, për shkak të së drejtës së privatësisë së klientëve të noterit. Pasi nuk ka asnjë dispozitë në LN që të ndalojë heqjet dorë para vdekjes, heqjet dorë në teori mund të ndodhin në zyrat e noterisë në çdo moment. Ligji duhet të sqarojë më tej dhe ta kufizojë këtë dispozitë.

Rekomandim:

Të adresohet çështja e heqjes dorë nga të drejtat trashëgimore nga gratë trashëgimtare. Me qëllim që të kufizohen heqjet dorë dhe t'i detyrojnë palët që të konsiderojnë me vëmendje nëse akti i heqjes dorë është ai i duhuri, duhet të konsiderohet vendosja i taksave apo tarifave noteriale më të rënda në aktin e tillë. Disa palë të interesit dhe OJQ-të për të drejtat e grave madje kanë sugjeruar ndalimin e heqjeve dorë të tilla, përkohësisht apo përgjithmonë. Megjithatë, e drejta për të hequr dorë nuk duhet të kufizohet në rastet që do të sillnin barrë financiare për gratë trashëgimtare. Për shembull, në rastet kur ka më shumë borxhe se pasuri, do të ishte e drejtë të ndahet barra në pjesë të barabarta. Fatkeqësisht, kjo jo çdoherë mundësohet nga sistemi aktual. Për më tepër, edhe nëse një gruaje trashëgimtare i jepet e drejta për të trashëguar, familja e saj mund ta bartë pjesën e saj tek të afërmit meshkuj më pas, duke hartuar dokumentin e dhurimit. Prandaj, me qëllim të pengimit të veprimeve të padrejta të heqjes dorë, mund të konsiderohet një taksë më e rëndë për kontratat e dhurimit ndërmjet të afërmeve dhe bashkë trashëgimtarëve, pavarësisht gjinisë së tyre.

Mbivendosja e juridiksionit të noterive dhe gjykatave:

Ashtu si u përmend më sipër, Ligji për Noterinë në Kosovë hyri në fuqi në maj 2012. Sipas këtij ligji, noteritë janë ligjërisht të autorizuar të vërtetojnë dhe verifikojnë çështjet jokontestimore të trashëgimisë.¹³ Megjithatë, Ligji për Trashëgiminë (LT) dhe Ligji për Procedurën Jokontestimore (LPJ) ende nuk janë ndryshuar apo harmonizuar siç parashihet me nenin 76, paragrafi 10 të Ligjit për Noterinë (LN). **Kjo ka krijuar një mospërputhje juridike ku gjykatat dhe noteritë të dy palët kanë juridiksion në lidhje me procedurat jokontestimore të trashëgimisë.** Si rezultat i kësaj procedure ligjore të paqartë, disa gjykata nuk i shqyrtojnë rastet jokontestimore të trashëgimisë, ndërsa të tjerat po.¹⁴ Më tej, lidhur me noteritë, disa mund të tregojnë ngurrim për të proceduar këto lloj kërkesash dhe në vend të kësaj i referojnë këto raste në gjykatë.¹⁵ Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se noteritë paguhen për transaksionet e verifikuara. Prandaj, nuk ka shumë gjasa që të gjithë noteritë të ndërpresin lëshimin e vendimeve trashëgimore pavarësisht mbivendosjes së juridiksionit. Edhe pse në teori noteritë duhet të veprojnë si masë mbrojtëse, shpesh kjo përgjegjësi merret përsipër varësisht nga individi dhe nuk garantohet. Kjo çon në mundësinë që disa transaksione të procedurës trashëgimore noteriale mund të ndodhin pa u kryer si duhet sqarimi dhe verifikimi i qëllimit.

Duke pasur parasysh mungesën e rregullave të qarta procedurale, është e vështirë të përshpejtohet zgjidhja e procedurave trashëgimore. Këto çështje procedurale zakonisht vonojnë apo edhe shpërfillin shqyrtimin e të drejtave të grave për pronë të paluajtshme, gjë që ndikon negativisht në statusin e tyre ekonomik.

Rekomandim:

Qeveria duhet të ndryshojë Ligjin për Trashëgiminë dhe Ligjin për Procedurën Jokontestimore, ashtu si parashihet me Ligjin për Noterinë, me qëllim të specifikimit të rolit të ri të noterive të autorizuar që të merren me procedurat trashëgimore dhe të shmangin mbivendosjen e kompetencave. Po ashtu rekomandohet që të përcaktohen, shpërndahen dhe të ndahen qartë kompetencat apo funksionet e noterive dhe gjykatave sa i përket procedurave të trashëgimisë.

¹³ Neni 29 paragrafi 1.4 I Ligjit për Noterinë (LN) shkruan: Funksionet e Noteriale Funksionet noteriale janë:

(...)

1.4. trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore;

(...)

1.7.1. nënshkrimi dhe vulosja e pronave që do të ndahen në kontekst të procedurës trashëgimore dhe të falimentimit;

(...)

¹⁴ “Programi i të Drejtave Pronësore (PDP) Çështjet Gjimore, Pronësore dhe Mundësitë Ekonomike në Kosovë”. (janar 2015) USAID. f7.

¹⁵ Përmendur në Punëtorinë/Tryezën e rumbullakët të projektit IPA Mbështetje e Kodit Civil dhe e të Drejtave të Pronësisë (KCDP) “Ligji për familjen dhe Ligji për Trashëgiminë: Probleme dhe Perspektiva”. Hotel Sirius, Prishtinë, e mërkure, 18 mars 2015.

Identifikimi i trashëgimtarëve:

Akti i vdekjes¹⁶ është dokumenti ligjor që përcakton trashëgimtarët e mundshëm dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të iniciohet ligjërisht procedurë trashëgimore. Ky dokument nxirret nga zyra komunale e gjendjes civile (ZKGJC). Në mënyrë që të merret akti i vdekjes, sipas nenit 137 të LPJ-së, anëtar i familjes duhet të paraqesë në ZKGJC dokumentet e mëposhtme:

1. Letërnjoftimin e personit/anëtarit të familjes që kërkon aktin e vdekjes,
2. Certifikatën mjekësore të vdekjes për të ndjerin, nëse ekziston,
3. Certifikatën e lindjes për secilin prej trashëgimtarëve të përmendur si kërkues, duke përcaktuar lidhjen e tyre me të vdekurin (neni 136 (d) i LPJ-së),
4. Të afërmit e tjerë të cilët mund të thirren sipas Ligjit të Trashëgimisë dhe gjithashtu persona tjerë të cilët kanë të drejta trashëgimore në bazë të testamentit (neni 136 (e) i LPJ-së [prandaj, nëse ekziston testamenti duhet të përmendet nga kërkuesi i aktit të vdekjes], dhe
5. Duhet të shënohen pronat që i nënshtrohen procedurave të trashëgimisë, duke përfshirë pronën e paluajtshme dhe të mbështetura me prova të pronësisë (transkriptim kadastral etj.)

Tjetër, ZKGJC-ja kompletton aktin e vdekjes sipas deklaratës së kërkuesit dhe dokumenteve mbështetëse të paraqitura, e cili pastaj vulozet, kopjohet për dosje dhe i jepet kërkuesit. Kërkuesi pastaj mund ta dërgojë atë në noteri apo në gjykatë me qëllim që të kërkojë apo të nisë procedurën trashëgimore në përputhje me rrethanat. Informacioni i dhënë nga kërkuesi zakonisht nuk verifikohet, dhe as nuk bëhet hulumtimi rutinë i ekzistimit të trashëgimtarëve shtesë (gra), pasi nuk ka kërkesë ligjore për një gjë të tillë, më pas asnjë nëpunës civil nuk kryen verifikime të tilla.

Është pohuar nga disa raporte dhe verifikuar nga EMM-ja¹⁷, se gratë shpesh janë përjashtuar nga akti i vdekjes nga familjet e tyre kur e kanë kërkuar atë nga ZKGJC-ja, duke e bërë kështu të pamundur realizimin e të drejtave të tyre trashëgimore. Sipas ligjit, ZKGJC-ja *ex officio* e dërgon aktin e vdekjes në “gjykatën për çështjet e trashëgimisë”¹⁸ (e cila tani është Gjykata Themelore ose notëritë). Megjithatë, në praktikë kjo nuk ka ndodhur. Në një sistem optimal, ZKGJC-ja duhet të jetë në gjendje të verifikojë të dhënat lidhur me anëtarët e familjes dhe të afërmit e të vdekurit përmes **Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile**. Megjithatë, pasi Regjistri Qendror i Gjendjes Civile nuk është ende i kompletuar dhe funksional dhe aftësitë administrative të ZKGJC-së janë mjaft të dobëta, nuk mund të verifikohet nëse kërkuesi ka përmbushur kërkesën ligjore për të shënuar të gjithë anëtarët e njohur të familjes së të ndjerit.

¹⁶ Referuar si “Akti i vdekjes” nga LNP (neni 136 *et alia*)

¹⁷ Konfirmuar në një takim me kryesuesin e ZKGJC-së në Lipjan, i mbajtur më 5 gusht 2015.

¹⁸ Neni 133 i LNP-së; nuk merr parasysh ligjet aktuale për gjykatat dhe për noterinë. “Gjykata për çështje trashëgimore” në këtë moment do të jetë, siç thuhet, Gjykata Themelore apo, në rastet jokontestimore, gjithashtu edhe Noteri.

Rekomandim:

ZKGJC-ja duhet të identifikojë organet e tjera publike që mund t'i ndihmojë ato lidhur me identifikimin e trashëgimtarëve.

- Pasi që pjesëtarët vendorë të Policisë së Kosovës, të tilla si njësitë policore të komunitetit, kanë përparësinë e lëvizshmërisë dhe njohjeve përbrenda shoqërisë, ata potencialisht mund t'i ndihmojnë ZKGJC-të.*
- Duhet të themelohen procedurat ku ZKGJC-ja të kërkojë që policia të vizitojë shtëpinë e të ndjerit dhe të kërkesit me qëllim të vërtetimit nëse ka më shumë anëtarë të familjes se sa janë të shënuar në aktin e vdekjes. Në rastin kur policia identifikon një trashëgimtar ligjor të të ndjerit që nuk është i përmendur në aktin e vdekjes, duhet të njoftojë shpejt prokurorët dhe mund të fillohen hetimet për deklarata të rreme (pasi kjo është në kundërshtim me nenin 158 të Kodit Penal të Kosovës, duke e bërë vepër të rëndë penale). Deri në këtë kohë, ZKGJC-ja tashmë duhet ta ketë lëshuar aktin e vdekjes dhe andaj është e rëndësishme të krijohet një mekanizëm për të siguruar që gjykatat dhe noteritë të informohen për pasaktësinë e tij.*
- Themelimi i një baze qendrore të të dhënave për noteritë është në vazhdim dhe afati i përlogaritur kohor për këtë projekt është maji 2015, megjithatë deri tani nuk është ende funksional (shih fusnotën 14). Ky do të ishte një kanal i përshtatshëm për t'i alarmuar noteritë me qëllim të shtyrjes apo verifikimit të procedurave lidhur me personat e vdekur.*
- Gjykata civile apo departamenti i saj për procedura trashëgimore duhet të njoftohet nga prokuroria dhe menjëherë të shënohet në regjistër se hetimet janë duke vazhduar. Ky sugjerim jepet si zgjidhje e përkohshme. Megjithatë, është e qartë se përparimet e vazhdueshme në Regjistrin elektronik Qendror të gjendjes civile (RQGJC) do të kenë gjithashtu ndikim pozitiv në identifikimin e trashëgimtarëve.*
- Kur RQGJC-ja të jetë më i sigurt, rutina e ZKGJC-së mund të ndryshohet në përputhje me të. Gjithashtu mund të shqyrtohet mundësia që trashëgimtarët të bëjnë betim gjatë dhënies së informacionit për aktin e vdekjes. Kjo nuk parashihet në LPJ, por zbatohet në disa shtete anëtare të BE-së. Kjo dispozitë do t'i fajësonte kryerësit për deklarim të rremë nën betim me dënim të shtuar nëse ata kërkojnë të mashtrojnë trashëgimtarët e ligjshëm për të drejtat e tyre të ligjshme me qëllim që të rrisin pjesën e tyre.*

Inventari dhe vlerësimi i trashëgimisë:

Përveç në rastin e një trashëgimie kontestuese që kërkon pjesëmarrje e një eksperti, **inventari dhe vlera e pronave bëhen nga vetë trashëgimtarët dhe vetëm verifikohen nga gjykata/noteria.** Për shkak të rregullave të paqarta dhe praktikave arbitrare lidhur me vlerësimin e vlerës së trashëgimisë¹⁹, përfshirë pasurinë e paluajtshme, gratë janë në rrezik për t'u mashtruar rreth trashëgimisë së tyre nga vlerësimin i gabuar i vlerës neto të pjesës së tyre. **Kështu, LPJ-së i mungojnë masat mbrojtëse të nevojshme për të parandaluar trashëgimtarët nga fshehja ose nënvlerësimi i pronave.** Aktualisht, e vetmja kërkesë është prania e dy qytetarëve të rritur si dëshmitarë gjatë bërjes së inventarit nga "shërbimi komunal kompetent apo zyrtari i gjykatës."²⁰ Sidoqoftë, nuk përcaktohet se dëshmitarët nuk mund të jenë pjesëmarrës në procedurën trashëgimore, gjë që krijon mundësi për situata të dukshme të konfliktit të interesit.

¹⁹ Në legjislacionet evropiane, zakonisht ekziston një vlerë e parashikuar zyrtare-kadastrale për secilën pronë të paluajtshme, e cila merret parasysh në procedurë jo-kontestimore të trashëgimisë, për shembull për llogaritjen e taksave që duhet paguar.

²⁰ Neni 141 paragrafi 3 LNP.

Neni 40, paragrafi 4 i LN-së përcakton se për aktet noteriale, dëshmitari nuk mund të jetë person me interes në transaksion dhe/ose në marrëdhënie me palën në atë akt apo që ka gjasa të përfitojë nga ai akt. Edhe pse ky ofron disa masa mbrojtëse kundër dëshmitarëve të njëanshëm dhe mund të jetë si shembull për LPJ-në, nuk është e qartë se si noteri mund ta verifikojë marrëdhënien që dëshmitari e ka me palët.

Rekomandim:

Të sigurohet ndarja e drejtë dhe jo diskriminuese e trashëgimisë.

Për të siguruar që të mos pranohet asnjë marrëveshje kundër vullnetit të ndonjë trashëgimtari, jepen këto rekomandime:

- Kriteret për marrëveshjen të specifikohen me ligj, duke ofruar masa mbrojtëse për ndarjen e drejtë ndërmjet trashëgimtarëve, pavarësisht gjinisë së tyre.*
- Të përcaktohet afati kohor për të arritur marrëveshjen me qëllim që të jetë siguruar identifikimi i të gjithë trashëgimtareve të ligjshëm dhe regjistrimi i të gjitha pronave.*
- Të përcaktohet se të gjithë trashëgimtarët duhet ta nënshkruajnë marrëveshjen para gjykatës apo noterit, duke mundësuar kështu verifikimin/analizimin e zotësisë dhe vullnetit së tyre.*

B) Regjistrimi i transaksioneve të pronave të paluajtshme

Regjistrimi i përbashkët i pronës

Prona e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës konsiderohet si pronë e përbashkët edhe nëse ajo nuk është e regjistruar në emrin e të dyve në RDPP.²¹ Megjithatë, për çdo transaksion të mëtejshëm në lidhje me pronën e paluajtshme, të dhënat në regjistër shërbejnë si bazë për diskutimin e të drejtave kontraktuese. Nëse bashkëshorti/ja nuk regjistrohet siç duhet, kjo mund të çojë në shmangien e të drejtave të bashkëshortëve. Në veçanti, kjo ka të bëjë me vendimet lidhur me transaksionet dhe ndarjen e të ardhurave që pasojnë pas rishitjes së pronës. Për më tepër, neni 36 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore (LPDTS) përcakton kërkesat për transaksionin e vlefshëm për të drejtat e pronës së paluajtshme, gjë që në atë moment është vetëm vullneti i “bartësit”. Që nga 4 marsi 2016, Udhëzimi Administrativ për Masat e Posaçme për Regjistrimin e Përbashkët të Pronës së Paluajtshme në Emër të të dy Bashkëshortëve²², i detyron të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, si edhe organet publike (neni 2) që “të zbatojnë masa e posaçme të përkohshme me qëllim të rritjes të numrit të grave të regjistruara si pronare të përbashkëta” (neni 4). Megjithatë, pasi pritet të shihet zbatimi i këtij udhëzimi administrativ, EMM-ja e ka të pamundur të vlerësojë nëse ky është veprim i mjaftueshëm për të siguruar regjistrimin e përbashkët.

Është e rëndësishme që të regjistrohen emrat e të dy bashkëshortëve dhe një sërë projektsh kanë promovuar së fundmi këtë regjistrim të përbashkët në Kosovë.²³ Përveç kësaj, regjistrimi i përbashkët me shumë gjasë do të lehtësojë pozitën e gruas së ve në procedurën trashëgimore, kur ajo kërkon të drejtat e saj ndaj të afërmeve të tjerë të të ndjerit.

Rekomandim:

Të theksohet e drejta e të dy bashkëshortëve për të vendosur rreth bashkëjetesës dhe të promovohet e drejta e grave që të marrin pjesë në vendimet rreth transaksioneve pronësore të familjes. Pasi neni 36 i LPDTS-së nuk jep mjaft garanci që gruaja të përfshihet, ai mund të ndryshohet për ta garantuar më të mirë këtë. Ndryshimi mund të konsistojë në atë që të kërkohej pjesëmarrja e të dy bashkëshortëve në transaksionet në rast të martesës apo bashkëjetesës, pavarësisht faktit se pronari formal i regjistruar i pronës apo i pronave është vetëm bashkëshorti.

²¹ Neni 47 dhe 50 i LF.

²² Udhëzimi Administrativ (GRK) nr. 03/2016 për Masat e Posaçme për Regjistrimin e Përbashkët të Pronës së paluajtshme në Emër të të dy Bashkëshortëve

²³ [Programi i të Drejtave Pronësore](#) USAID: \$8,343,070 objektivi 3 (nga 4) është ” Përmirësimi i të Drejtave të Grave [për Shfrytëzimin e pronës në Praktikë](#)”; IPA “[Mbështetje për Kodin Civil dhe të Drejtave Pronësore](#)” është përqendruar në [zotërimin e tokës me qasje gjinore](#); KB-ja ka zbatuar projektin “[Të drejtat Pronësore në Kosovë: “Mos hesht”](#)” OSBE-ja ka pasur disa projekte të tilla si “[Udhëzuesi Informativ për Qasjen e Grave dhe Burrave në të Drejtat e tyre Pronësore dhe Banesore në Kosovë](#)”.

Regjistrimi në kadastrë

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) bën mbikëqyrjen e përgjithshme të aktiviteteve kadastrale dhe siguron që zyra komunale kadastrale (ZKK) të jetë e pajisur me trajnimin e nevojshëm për të kryer përgjegjësitë e veta.²⁴ Aktualisht, nuk duket të jetë marrë ndonjë masë disiplinore për zyrtarët e ZKK-së, të cilët nuk i regjistrojnë të dy bashkëshortët ashtu siç parashihet me ligj. Edhe pse Agjencitë Kadastrale, zakonisht janë të detyruara me vendimet e gjykatave apo të noterive publike, ato duhet që në mënyre ideale të funksionojnë si “kontroll i cilësisë”. Ata mund ta bëjnë këtë duke siguruar që është bërë regjistrimi i emrave të të dy bashkëshortëve kur është e mundur dhe sa herë kur kjo mundësi është anashkaluar nga gjykatat dhe noterët.

Rekomandim:

Të përmirësohet Administrata Kadastrale me qëllim të nxitjes të regjistrimit të pronave në emër të të dy bashkëshortëve/grave. AKK-ja duhet të plotësojë nevojat për trajnime, përfshirë seminarët për Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Familjen, me qëllim që t’u bëhet e qartë zyrtarëve të ZKK-së se realizimi i drejtave të grave është i rëndësishëm. Për të siguruar që ZKK-të veprojnë në përputhje me dispozitat, AKK-ja duhet të kryejë kontrole të rastësishme dhe praktika monitoruese dhe të identifikojë fushat problematike. Udhëzimi administrativ për ZKK-të duhet të ndryshohet në atë mënyrë që të obligohen që ato të bëjnë verifikimin përmes Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile nëse personi që aplikon për regjistrim e pronësisë për pronën është i martuar ose jo, dhe nëse është, të sigurohet që emri i bashkëshortes të regjistrohet po ashtu sikurse parashihet me nenin 47 të LF-së. Gjithashtu, UAZLK-ja duhet të harmonizohet me nenin 47 të LF-së: “Shënimet e Pronarit” duhet të përfshijnë gjendjen civile dhe emrin eventual të bashkëshortit/bashkëshortes (shih nenin 5 paragrafi 2). Për ta përhapur më tej njohurinë rreth dispozitave në nenin 47 dhe 50 të LF-së te qytetarët, zyrtarët mund të fillojnë gjithashtu praktikën që ta pyesin aplikantin rreth gjendjes së tij/saj civile.

Tarifat dhe taksat

Një pengesë administrative që mund të hiqet lehtë është praktika e vërejtur në disa komuna, ajo **taksimit të dyfishtë të transaksionit në bashkëshortët zgjedhim të regjistrojnë të dy emrat në RDPP**. Për shembull, neni 24, paragrafi 3 i Rregullores për Tatimin e Transaksioneve të Pronës së Paluajtshme në Komunën e Podujevës, shkruan se secili blerës duhet të paguajë taksën e transaksionit veç e veç. Po ashtu, neni 4 paragrafi 1 i Rregullores për Tarifa, Tarifa Komunale dhe Gjopa e Komunës së Prishtinës shkruan se **çdo blerësi** do t’i vendoset veçmas taksa e transaksionit për njësi në kontratën e përbashkët. Këto dispozita mund të shihen si inkurajim për çiftet që të mos bëjnë regjistrimin si pronarë për të dy bashkëshortët pasi kjo do të jetë më e shtrenjtë. Një zgjidhje praktike do të ishte që taksa për pronën e paluajtshme të ndahej në dy pjesë (secili bashkëshort paguan gjysmën e taksës). Lidhur me tarifat për shërbime kadastrale të kryera nga ZKK-të, ekziston Udhëzimi Administrativ i prillit 2014²⁵, që përcakton lartësinë e taksave dhe kështu nuk lejon

²⁴ Neni 4 i Ligjit për Kadastrë.

²⁵ Udhëzimi Administrativ MESP NR 08/2014 për Tarifat për Shërbimet për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga

komunat që të caktojnë tarifa të ndryshme. Megjithatë, hulumtimi i EMM-së në rregulloret komunale ka gjetur se **ky udhëzim administrativ nuk është zbatuar**. Udhëzimi i ri administrativ i marsit 2016 deklaroi më tej se nëse çiftet kanë siguruar regjistrim të përbashkët, ata mund të përjashtohen nga tarifa e regjistrimit të përcaktuar në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2014 për Tarifat dhe Shërbimet e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme në zyrat komunale kadastrale.

Rekomandim:

Ministria për Vetëqeverisje Vendore duhet të bëjë harmonizimin e rregulloreve komunale për taksat dhe tarifën. Duhet të sigurohet që çiftet që blejnë dhe regjistrojnë një shtëpi në emër të të dy bashkëshortëve të mos u vendosen tarifa më të larta sesa në rastet kur regjistrohet vetëm një emër. Gjithashtu, taksa e transaksionit duhet të vendoset vetëm një herë për çdo transaksion dhe jo për çdo blerës. Të gjitha rregulloret komunale për taksat dhe tarifën duhet të harmonizohen në tërë Kosovën, mundësisht përmes udhëzimit të lëshuar nga Ministria për Vetëqeverisje Lokale.

5) Mungesa e mbrojtjes të grave për të drejtën trashëgimore për pronën e paluajtshme nga institucionet noteriale të Kosovës

Shqetësimi kryesor i identifikuar nga EMT-ja është mbizotërimi i akteve të heqjes dorë prej grave për të drejtat trashëgimore, posaçërisht në zonat rurale. Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë se në pjesën dërrmuese të procedurave të trashëgimisë, gratë kanë qenë trashëgimtare potenciale. Megjithatë, përqindja e lëndëve ku këto gra janë shpallur trashëgimtare është shumë e ulët (në përgjithësi nën 20%). Në pjesën tjetër të rasteve, trashëgimtarët gra kanë hequr dorë nga trashëgimia. Kjo e ve në pikëpyetje rolin e noterisë si mbrojtës i ligjshmërisë, drejtësisë dhe barazisë gjinore. Është e vështirë të përcaktohet nëse të gjitha gratë që kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre kanë qenë tërësisht të informuara nga noteri rreth të drejtave të tyre ligjore apo vlerës së heqjes dorë. Për më tepër, ky raport nuk mund të arrijë në përfundimin nëse noteri i ka marrë të gjitha masat mbrojtëse në përputhje me të drejtën zakonore për të siguruar dhe respektuar që vendimet e grave kanë qenë të tyre dhe jo për shkak të trysnisë familjare. Në një situatë ideale të barazisë gjinore, heqja dorë nga të drejtat e trashëgimisë do të ishte e kufizuar, pavarësisht gjinisë së trashëgimtarit dhe kjo zakonisht vetëm si rezultat i rasteve kur do të trashëgoheshin më shumë borxhe sesa pasuri. Megjithatë, në pjesën më të madhe të rasteve nuk kemi të bëjmë me rastin e tillë ku gratë heqin dorë. Ndonëse noteritë janë në pozitë të përkryer që të kufizojnë efektin e heqjes dorë, shpesh nuk është e qartë nëse ata po e bëjnë këtë.

Ndonëse EMT-ja ka mbledhur të dhëna të reja që hedhin dritë në realitetin e situatës së të drejtave trashëgimore të grave për pronën e paluajtshme, informacionet e mbledhura nga 19 noteritë në mbarë Kosovën²⁶ paraqesin gjithashtu probleme. Fillimisht, disa noteri nuk i kishin kompletuar informacionet. Shumë nga noteritë nuk kanë dhënë numrin e përgjithshëm të akteve ligjore të krahasuara me numrin e akteve ku gratë kanë marrë pjesë. Pa të dhënat e detajuara është vështirë të kuptohet pamja e plotë. Së dyti, mund të thuhet se disa noterive u ka munguar paanësia, kjo e provuar. Për shembull, pjesa dërrmuese e të dhënave tregojnë se gratë heqin dorë nga trashëgimia e tyre në dobi të anëtarëve meshkuj të familjes. Por, gjatë përpilimit të të dhënave për këtë raport, një noter insistonte në nënvizimin e faktit se në disa raste gratë hiqnin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore në dobi të motrave dhe trashëgimtareve të tjera gra. Ndonëse kjo mund të jetë e vërtetë, numri i rasteve kur kjo gjë ndodh nuk është tërësisht përfaqësuese dhe e vë në pikëpyetje të botëkuptimin që disa noterë mund të kenë për rolin e tyre si mbrojtës të të drejtave trashëgimore të grave.

Fatmirësisht, disa zyra të noterëve kanë ofruar të dhëna të plota dhe të detajuara, përfshirë numrat e

²⁶ Shtojca I.

përgjithshëm që nevojiten për ta lehtësuar krahasimin me numrin e përfituesve gra. Sipas këtyre të dhënave, që e nënvizojnë gjendjen aktuale të qasjes së grave në trashëgiminë e pronave të paluajtshme, ato përfitojnë vetëm në rreth 15% të numrit total të transaksioneve pronësore. Në vendet rurale, kjo përqindje është edhe më e vogël. Për shembull, vetëm 6% e shitjeve të pronave (11 nga 163 kontrata) kanë qenë në dobi për gratë në zyrën e noterit C në Gjilan. Shifrat e marra nga noteritë, sido qoftë, përputhen në mënyrë të përkryer si me përqindjet e lëndëve civile të ngritura nga palët ankuese gra ashtu edhe me përqindjet e grave që janë pronare të pronave, sipas kadastrit.

Prandaj, pavarësisht nga mungesa e të dhënave të plota për të gjitha noteritë në Kosovë, provat e gjetura nga EMT-ja nxjerrin qartë në pah mungesën e mbrojtjes të grave në trashëgiminë e pronës së paluajtshme nga noteritë e Kosovës.

6) Përfundime

Ky raport ka shtjelluar qasjen e grave në pronën e paluajtshme të trashëguar në Kosovë. Duke i përdorur informacionet e dhëna nga noteritë dhe gjykatat, së bashku me analizat e studimit të rastit, ky raport ka nxjerrë në shesh disa mangësi legislative në shumë nivele dhe ndërinstitutionale, përfshirë mungesën e rregullave të qarta procedurale në kornizën ligjore.

Së pari, brenda legjislacionit për trashëgiminë ekzistojnë mbivendosje të juridiksionit mes noterive dhe gjykatave për rastet e jokontestimore të trashëgimisë. Për më tepër, në sistemin ligjor aktual, ZKGJC-ja nuk është në gjendje të verifikojë nëse gratë lihen jashtë aktit të vdekjes dhe LPJK-ja nuk ofron masa të mjaftueshme mbrojtëse për të siguruar që inventari, si dhe ndarja e trashëgimisë nuk shkon në dëm të trashëgimtarëve gra.

Së dyti, ashtu si është nënvizuar në të dhënat e mbledhura për këtë raport, heqja dorë nga gratë është çështje madhore dhe legjislacioni që merret me këtë çështje është shpesh i paqartë dhe ka mungesë të masave mbrojtëse.

Përveç kësaj, nëse gratë nuk regjistrohen në mënyrën e duhur në pronën e paluajtshme, ato mund të mos kenë të drejtat e njëjta kontraktuese dhe institucionet si Agjencia Kadastrale e Kosovës aktualisht nuk po sigurojnë që të bëhet regjistrimi i të dy bashkëshortëve.

Së fundi, ekzistojnë tarifa dhe taksa lidhur me transaksionet në disa noteritë dhe ZGJC që mund të çojë në regjistrimin të më pak grave. Hulumtimi i EMT-së për noteritë nxjerr në pah mungesën e mbrojtjes që këto zyra ofrojnë për të drejtat trashëgimore të grave, pavarësisht akteve të panumërta ligjore që ata vërtetojnë sikurse është heqja dorë.

Si përfundim, sistemi aktual legjislativ është i dobët dhe problematik lidhur me qasjen e grave në trashëgiminë e pronës së paluajtshme. Ndonëse në shikim të parë duket se i plotëson standardet evropiane të barazisë, ky legjislacion ekziston përbrenda kontekstit kulturor ku të drejtat e barabarta të trashëgimisë për gratë nuk janë (gjithnjë) normë. Si rezultat, korniza aktuale legislative është e pamjaftueshme që të ballafaqohet me praktikat tradicionale dhe ekziston nevoja për legjislacion dhe rregulla procedurale më të qarta dhe të përpikta. Sipas kësaj analize, nevojiten amendamente në ligje për të shmangur mangësitë, për të harmonizuar rregullat dhe për të vepruar si masë parandaluese ndaj rrethanave ku mund të shkelen të drejtat ligjore të grave. Kjo kërkon përpjekje të përkushtuar nga Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, noteritë dhe gjykatat për të siguruar zvogëlimin në minimum të mundësisë të anashkalimit të ligjit duke ofruar kështu grave garanci të vërteta (jo formale) ligjore. Institucionet e ndryshme të angazhuara, si kadastri, noteritë dhe ZKGJC-ja, duhet të veprojnë si organe të kontrollit të baraspeshës për të siguruar që informacionet e trashëgimisë të jenë të sakta dhe të ketë ndarje të barabartë ndërmjet trashëgimtarëve. Të gjitha palët e përfshira në promovimin e të drejtave të grave duhet të vazhdojnë t'i kushtojnë vëmendje të

vazhdueshme kësaj çështjeje, pasi sigurimi që sistemi juridik të mbrojë të drejtat e qytetarëve të vet është i domosdoshëm për një shtet të fuqishëm. Rekomandimet e identifikuara në këtë raport do të ndihmojnë Qeverinë e Kosovës së bashku me komunitetin ndërkombëtar, të zbatojnë sundim më të madh të ligjit dhe mbrojtje të të drejtave për të gjithë njerëzit.

Rekomandime:

1. **Qeveria të ndryshojë Ligjin për Trashëgiminë dhe Ligjin për Procedurat Jashtë-Kontestimore**, ashtu si parashihet me Ligjin për Noterinë, me qëllim që të përcaktohet roli i ri i noterëve të autorizuar që merren me procedurat trashëgimore dhe të shmanget mbivendosja e kompetencave.

- Po ashtu rekomandohet që të përcaktohen, shpërndahen dhe të ndahen qartë kompetencat apo funksionet e noterive dhe gjykatave sa i përket procedurave të trashëgimisë.

2. **Të identifikohen organet e tjera publike që mund të ndihmojnë ZKGJC-të lidhur me identifikimin e trashëgimtarëve.**

- Si pjesëtarë vendorë të Policisë së Kosovës, të tilla si njësitë policore të komunitetit, duke pasur përparësinë e lëvizshmërisë dhe njohjes përbrenda shoqërisë në fushat e tyre të përgjegjësisë, ata mund të ndihmojnë potencialisht ZKGJC-të.
- Duhet të përcaktohen procedurat kur ZKGJC-ja të kërkojë që policia të vizitojë shtëpinë e të ndjerit dhe të kërkesit me qëllim të vërtetimit nëse ka më shumë anëtarë të familjes se sa janë të shënuar në aktin e vdekjes.²⁷ Kur policia identifikon se një trashëgimtar ligjor i të ndjerit që nuk është i përmendur në aktin e vdekjes, të njofton shpejt prokurorët dhe të fillohen hetimet për deklarata të rreme²⁸ (pasi që kjo është në kundërshtim me nenin 158 të Kodit Penal të Kosovës, dhe kjo e bën vepër të rëndë penale). Deri në atë kohë, ZKGJC-ja tashme do ta ketë lëshuar aktin e vdekjes dhe prandaj është e rëndësishme të krijohet një mekanizëm për të siguruar që gjykatat dhe noteritë të informohen për pasaktësinë e tij.
- Themelimi i një baze qendrore të dhënave për noteritë është në vazhdim. Afati i përlllogaritur kohor për këtë projekt është maji 2015²⁹, por për momentin nuk është tërësisht funksional (shih fusnotën 14). Ky mund të jetë kanal i përshtatshëm për t'i alarmuar noteritë me qëllim të shtyrjes apo verifikimit të procedurave lidhur me personat e vdekur. Gjykata civile apo departamenti i saj për procedurën trashëgimore, duhet të njoftohen nga prokuroria dhe menjëherë të shënohet në regjistër se hetimet janë në vazhdim. Ky sugjerim jepet si zgjidhje e përkohshme. Megjithatë, është e qartë se përparimet e vazhdueshme në regjistrin qendror të

²⁷ Praktika të ngjashme zbatohen ndërmjet regjistrave civil dhe njërive policore komunale në disa shtete të BE-së sikurse Spanja, ku çfarëdo regjistrimi civil mund të verifikohet në mënyrë rutine nga policia për t'iu shmangur mashtrimeve.

²⁸ Siç specifikohet në nenin 392 të Kodit Penal.

²⁹ Sipas bisedave të mbajtura në mars të vitit 2015 me Odën e Noterëve. Përditësimi më 13 gusht 2015: Baza qendrore e të dhënave është gati, por përdorimi i saj nuk është zbatuar ende. Sipas administratorit të Dhomës, noteritë janë duke u udhëzuar për përdorimin e saj, e cila do të jetë e detyrueshme më 1 shtator 2016 për të gjitha zyrat noteriale.

gjendjes civile (RQGJC) të formës elektronike do të kenë gjithashtu një ndikim pozitiv në identifikimin e trashëgimtarëve.

- Kur RQSC- të jetë më i sigurt, rutinat e ZKGJC-së mund të ndryshohen në përputhje me të. Gjithashtu mund të shqyrtohet mundësia që trashëgimtarët të bëjnë betim gjatë dhënies së informacioneve për aktin e vdekjes. Kjo nuk parashihet në LPJ, por zbatohet në disa shtete anëtare të BE-së.³⁰ Dispozita e tillë do të fajësonte kryerësit për deklarim të rremë nën betim me dënim të shtuar nëse ata përpiqen t'i mashtrojnë trashëgimtarët legjitim për të drejtat e tyre ligjore me qëllim të rritjes së pjesës së tyre.

3. Të sigurohet ndarje e drejtë dhe jo diskriminuese e trashëgimisë. Për të siguruar që të mos pranohet asnjë marrëveshje kundër vullnetit të trashëgimtarit, jepen këto rekomandime:

- Kriteret për marrëveshjen të specifikohen me ligj, duke ofruar masa mbrojtëse për ndarjen e drejtë ndërmjet trashëgimtarëve, pavarësisht gjinisë së tyre.
- Të përcaktohet afati kohor për të arritur marrëveshjen me qëllim që të sigurohet se është bërë identifikimi i trashëgimtarëve të ligjshëm dhe regjistrim i pronës.
- Të përcaktohet se të gjithë trashëgimtarët duhet ta nënshkruajnë marrëveshjen para gjykatës apo noterit, duke mundësuar kështu verifikimin/analizimin e zotësisë dhe vullnetit të tyre.

4. Të adresohet çështja e heqjes dorë nga gratë trashëgimtare për të drejtat trashëgimore.

- Me qëllim që të kufizohen heqjet dorë dhe të detyrohen palët që të konsiderojnë me vëmendje nëse akti i heqjes dorë është ai i dhuri, duhet të konsiderohet vendosja e taksave apo tarifave noteriale më të rënda për aktin e të tillë.
- Disa palë të interesit dhe OJQ-të për të drejtat e grave madje kanë sugjeruar ndalimin e tillë të heqjeve dorë, përkohësisht apo përgjithmonë. Megjithatë, e drejta për të hequr dorë nuk duhet të kufizohet në rastet që do të sillnin barrë financiare për trashëgimtarët gra. Për shembull, në rastet kur ka më shumë borxhe se pasuri, do të ishte e drejtë të ndahet barra në pjesë të barabarta. Fatkeqësisht, kjo jo çdoherë mundësohet nga sistemi aktual.
- Për më tepër, edhe nëse një trashëgimtareje grua i jepet e drejta për të trashëguar, familja më pas mund t'ia transferojë pjesën e saj të afërmeve meshkuj duke hartuar një dokument dhurimi. Prandaj, me qëllim të pengimit të veprimeve të padrejta të heqjes dorë, mund të konsiderohet një taksë më e rëndë për kontratat e dhurimit ndërmjet të afërmeve dhe bashkë trashëgimtarëve.

³⁰ Në Britani, aplikanti për grant bën betimin në zyrën lokale të verifikimit.

5. Të theksohet e drejta e të dy bashkëshortëve që të vendosin rreth bashkëjetesës dhe të promovohet e drejta e grave që të marrin pjesë në vendimet rreth transaksioneve pronësore të familjes.

- Pasi neni 36 i LPTDS-së nuk ofron mjaft për të siguruar që gruaja të përfshihet, ai mund të ndryshohet që ta garantojë këtë më mirë. Ndryshimi mund të konsistojë në atë që të kërkohet pjesëmarrja e të dy bashkëshortëve në transaksionet në rast të martesës apo bashkëjetesës, pavarësisht faktit se pronari formal i regjistruar i pronës apo i pronave është vetëm bashkëshorti.

6. Të përmirësohet administrata kadastrale me qëllim të shtimit të regjistrimit të pronave në emër të të dy bashkëshortëve/grave.

- AKK-ja duhet t'i plotësojë nevojat për trajnime, përfshirë seminarët për Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Familjen, me qëllim që t'ua bëjë të qartë zyrtarëve të ZKK-së se realizimi i të drejtave pronësore të grave është i rëndësishëm.
- Për të siguruar që ZKK-të veprojnë në përputhje me dispozitat, AKK-ja duhet të kryejë kontrolle të rastësishme dhe praktika monitoruese dhe të identifikojë fushat problematike.
- Udhëzimi administrativ për ZKK-të të ndryshohet në atë mënyrë që ata të obligohen që ta bëjnë verifikimin përmes RQGJC-së nëse personi që aplikon për regjistrimin e pronësive për pronën është i martuar ose jo, dhe nëse është, të sigurohet që emri i bashkëshortes të regjistrohet po ashtu sikurse parashihet me nenin 47 të LF-së.
- Gjithashtu, UAZLK-ja të harmonizohet me nenin 47 të LF-së: "Shënimet e Pronarit" duhet të përfshijnë gjendjen civile dhe emrin eventuale të bashkëshortit/bashkëshortes (shih nenin 5 paragrafi 2).
- Për ta përhapur më tej njohurinë rreth dispozitave të nenit 47 dhe 50 të LF-së te qytetarët, zyrtarët mund të fillojnë gjithashtu praktikën që ta pyesin aplikantin rreth gjendjes së tij/saj civile.

7. Ministria për Vetëqeverisjen Vendore të harmonizojë rregulloret komunale për taksat dhe tarifat.

- Duhet të sigurohet që çiftet që blejnë dhe regjistrojnë një shtëpi në emër të të dy bashkëshortëve të mos u vendosen tarifa më të larta se sa në rastet kur është i regjistruar vetëm një emër.
- Gjithashtu, taksa e transaksionit duhet të vendoset vetëm një herë për çdo

transaksion dhe jo për çdo blerës. Të gjitha rregulloret komunale për taksat dhe tarifatat duhet të harmonizohen në tërë Kosovën, mundësisht përmes udhëzimit të lëshuar nga Ministria për Vetëqeverisje Vendore.

8. **Të nxirren udhëzime të qarta për pjesëtarët e noterive dhe të kryhen verifikime shitesë dhe të rastësishme dhe të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i praktikave ekzistuese diskriminuese nga Oda e Noterëve.** Është e domosdoshme të rriten masat mbrojtëse për shprehjen e vullnetit të lirë të palëve në aktet e vërtetuara.
9. **Të inkurajohet Qeveria e Kosovës që të formojë një grup pune** që do të ketë për detyrë kryerjen e shqyrtimit sistematik të ligjeve dhe praktikave në fushën e qasjes së grave në të drejtat trashëgimore të pronës së paluajtshme dhe në përputhje me këtë të propozojë amendamente dhe masa të domosdoshme mbrojtëse.
- 10 **Të themelohet Shërbimit i posaçëm me synim Ndihmën Juridike (jo domosdoshmërisht pa pagesë për çdo shfrytëzues) për të rritur dhe lehtësuar qasjen e grave në informacionin rreth të drejtave të tyre dhe mënyrave për t'i mbrojtur ato në gjykata dhe institucione të tjera.**
 - Kjo mund të shoqërohet me fushatë në media për rritjen e vetëdijes rreth barazisë formale të të drejtave pronësore, rreth natyrës jo të detyrueshme të ligjeve dhe traditave zakonore dhe rreth ekzistimit të vet Shërbimit të Ndihmës Juridike.



ODA E NOTERËVE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
NOTARSKA KOMORA REPUBLIKE KOSOVA - NOTARY CHAMBER OF THE REPUBLIC
OF KOSOVO

DATE:	21.04.2015
Reference:	Ref. Nr. 19/15
FOR:	Z. Andreas Moreno, Monitorues i Drejtësisë-EULEX.
FROM:	Erdon Gjinolli, Shef i Shërbimeve Administrative ONK
SUBJECT:	Përgjigje ndaj kërkesës

I nderuari Z. Moreno,

Në bazë të kërkesës suaj, Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës, pas pranimit të të dhënave statistikore nga disa zyra të noterëve në territorin e Republikës së Kosovës, paraqet këto informacione:

Shënim: Disa statistika janë llogaritur në bazë të lëndëve të përfunduara nga noterët, ndërsa të dhënat e tjera në bazë të numrit të përfituesve të gjinisë femërore, varësisht nga të dhënat e paraqitura nga noterët.

1. Zyra e Noterit A, Istog:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 30 lëndë.
- Aktgjykim për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 45 gra.
- Vendime të trashëgimisë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 102 gra.

2. Zyra e Noterit B, Shtime:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 55 lëndë.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 27 gra.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 111 gra.

- Lëndë ku gratë janë palë në kontratën e dhurimit; 18 gra.

3. Zyra e Noterit C, Gjilan:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër: nga 163 kontrata në 11 lëndë përfituese janë gratë.
- Lëndë ku gratë janë palë në kontratën e dhurimit, nga gjithsej 52 kontrata, vetëm një rast ka qenë femër.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 10 lëndë, nga 30 raste.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 20 lëndë, nga 30 raste.

4. Zyra e Noterit D, Mitrovicë:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 7 lëndë;
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, 5 lëndë;
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 37 lëndë;

5. Zyra e Noterit E, Prishtinë:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 203 lëndë. (Palët në kontratën e shitjes, shkëmbimit, investimit, dhurimit)
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 13 lëndë.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 27 lëndë.

6. Zyra e Noterit F, Prizren:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, në gjithsej 29 lëndë.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, në gjithsej 15 lëndë - 19 gra.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore në dobi të vëllezërve apo nipave, gjithsej 35 lëndë - 81 gra.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore në dobi të motrës, nënës, vajzës, mbesës, gjithsej 10 lëndë - 16 gra.

7. Zyra e Noterit e G, Klinë:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme kur përfituesi është femër, në total 12 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 8 lëndë.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore në dobi të vëllezërve apo nipave, gjithsej 16 lëndë.
- Aktgjykime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore në dobi të motrës, nënës, vajzës, mbesës, gjithsej 3 lëndë.

8. Zyra e Noterit H, Viti:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 9 lëndë.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshje për dhurim, 2 lëndë.
- Vendim për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 4 gra.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 21 gra.

9. Zyra e Noterit I, Suharekë:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, 16 lëndë gjithsej.
- Vendim për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 25 gra.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 238 gra.

10. Zyra e Noterit J, Prizren:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 75 lëndë, nga të cilat 49 si shitëse dhe 26 si blerëse.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 52 gra.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 80 gra.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për dhurim, 1 femër.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për pronësinë e përhershme, 2 femra.

11. Zyra e Noterit K , Kaçanik:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, në total 12 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 4 gra.
- Vendime të trashëgimisë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, NUK KA ASNJË.

12. Zyra e Noterit L, Prizren:

- Kontrata të shitjes së pronës së paluajtshme kur përfituesi është femër, gjithsej 16 gra.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 16 gra.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, 71 gra.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për dhurim, 6 femra.

13. Zyra e Noterit M, Prishtinë:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 60 gra.
- Vendime të trashëgimisë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 18 gra.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për dhurim, 4 femra.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për pronësinë e përhershme, 1 lëndë.
- Lëndë ku gratë janë palë në marrëveshjen për shkëmbim, 1 lëndë.

14. Zyra e Noterit N, Ferizaj:

- Kontrata të shitjes të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 13 lëndë, gjithsej 202 kontrata.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 21 lëndë nga gjithsej 48 aktgjykime.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga masat trashëgimore, gjithsej 27 lëndë, nga gjithsej 48 lëndë.

15. Zyra e Noterit O, Kamenica:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme kur përfituesi është femër, gjithsej 57 lëndë, nga të cilat 22 janë blerëse dhe 35 në cilësinë e shitëseve.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 18 lëndë.

- Vendimet për trashëgiminë kur gratë janë tërhequr nga trashëgimia, 44 lëndë.

16. Zyra e Noterit P, Prizren:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 12 lëndë, nga të cilat 8 lëndë janë si shitës dhe 4 lëndë si blerës.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, në total 36 lëndë
- Vendime për trashëgiminë kur gratë janë tërhequr nga trashëgimia, 67 femra.
- Lëndë ku gratë janë palë në kontratën e dhurimit, 15 femra.
- Lëndë ku gratë janë palë në kontratën e pronësisë së përhershme, 4 femra.

17. Zyra e Noterit Q, Suhareka:

- Vendim për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, 1 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 5 femra, nga gjithsej 37 lëndë.

18. Zyra e Noterit R, Viti:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 18 lëndë, nga gjithsej 154 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 17 lëndë, nga gjithsej 77 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë kur gratë janë tërhequr nga trashëgimia, gjithsej 60 lëndë nga 77 lëndë.
- Lëndë ku gratë janë palë në kontratën e dhurimit, 15 femra.
- Lëndë ku gratë janë palë në kontratë për pronësinë e përhershme, 4 femra.

19. Zyra e Noterit S, Prizren:

- Kontrata të transaksionit të pronës së paluajtshme ku përfituesi është femër, gjithsej 42 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë shpallur trashëgimtare, gjithsej 33 lëndë.
- Vendime për trashëgiminë ku gratë janë tërhequr nga trashëgimia në dobi të vëllezërve të tyre, 24 lëndë.

Prishtinë: 21.04.2015